



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 76

Prishtinë, më 28.5.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Etem Arifi.

Mungoi : Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MBPZHR dhe Ministri i MMPH.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.5.2012,
3. Shqyrtimi i marrëveshjes për rimbursimin e verës me Ministrin e Financave dhe Ministrin e Bujqësisë,
4. Shqyrtimi i sfidave të raportit të progresit me Ministrin e Bujqësisë,
5. Përgatitjet e Komisionit për organizimin e debatit në Pejë për Projektligjin e parkut “Bjeshkët e Nemuna”.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.5.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23.5.2012.

3. Rimbursimi i verës dhe raporti i progresit

Kryetari Nait Hasani falënderoi për pjesëmarrje Ministrin Blerand Stavileci dhe zv. Ministrin **Ramadan Avdiu** dhe rikujtoi për marrëveshjen e arritur në këtë komision në fund të vitit 2011 për kompensimin e fermerëve për venë, tha se Ministria e Bujqësisë ka marr obligimin me krye pagesën ndërsa Ministria e financave ka marr obligimin për mbështetje të pagesës. **Ministri Stavileci** konfirmoi se ky obligim do të realizohet ngase me rishikim të buxhetit (sot ka qenë dita e fundit për dorëzimin e kërkesave për rishikim) është paraparë obligimi i marr në këtë komision. Z. **Avdiu** gjithashtu konfirmoi se Ministria e Financave ka marr përsipër të mbështes këtë obligim. Në vazhdim kryetari hapi diskutimin rreth çështjeve për pikat e rendit të ditës në praninë e zyrtarëve të dy ministrive. **Liburn Aliu** u interesua edhe për produktet tjera bujqësore të ndodhë kjo mënyrë e kompensimit, në mënyrë që akciza pastaj të rimbursohet, gjithashtu kërkoi që ministria të ngritë prodhimin duke mbështetur të gjithë ata që konkurrojnë për të punuar me lehtësira të ndryshme. Ai pyeti edhe për pikat grumbulluese, sidomos për atë në Rahovec për specat. Ministri ilustroi këtë ecure në rritje ngase si tha ai më 2010 ka pasur 6000 aplikime ndërsa tani janë 20000, dhe premtoi se komisioni do të njoftohet edhe zyrtarisht. Ministria do të angazhohet në mbështetjen e këtyre kërkesave duke subvencionuar ashtu si është njoftuar publiku, 100 euro për hektar, 50 euro për lopë, 50 euro për dele etj. Të gjithë fermerët do të njoftohen për arsyet e fitimit apo mosfitimit të subvencionit. Pikat grumbulluese do të funksionalizohen shumë më mirë tani e tutje, me ndihmën e vet kompanive të interesuara, mirëpo duhet të kemi parasysh që ende jemi në nivelin selektiv, përfundoi. **Rasim Demiri** u angazhua për miratimin e kërkesave të bujqve nga komuniteti boshnjak, ngase absurde është që nga 24.000 kërkesa të mos miratohet asnjë. Ministri premtoi se bashkë me deputetin do të shkojnë në komunën përkatëse rreth interesimit për këtë çështje, por rikujtoi se ministria tani shfrytëzon edhe sistemin e cilësisë dhe kriteret tjera të rëndësishme për të fituar dikush subvencionin, ngase do të fitoi ai që punon më së tepërmi. Të gjitha këto çështje dhe punë për ministrinë e bujqësisë vështirësohen për shkak të mungesës së të dhënave, shtoi Ministri. **Afërdita Berisha** pyeti për prodhimet organike (bio) për shkak se në procedurë është ligji për këto prodhime. Ministri garantoj se Qeveria është e gatshme për hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe ishte i mendimit se nuk duhet të ketë implikime financiare. Ministria është në kontroll të këtyre prodhuesve, mirëpo kuptohet, jo sikurse në sistemet evropiane. Afërdita Berisha vazhdoi me apelin për MB rreth angazhimeve, në mënyrë që mos të dëgjohet ankesa nga bujqit "nuk kamë hesap me punua tokën". **Ministri** reagoi dhe tha "posa të dëgjoni këtë, duhet të pyetni fermerin : a jeni të regjistruar" ngase një fermer nuk mund të fitoi lehtësira nëse nuk është i regjistruar, përndryshe si të dokumentohet nëse një bujk merr 20 litra naftë dhe të gjitha ato i përdor për bujqësi. Ai konstatoi dhe përsëriti atë që tha më lartë : regjistrimi në bujqësi duhet sa më shpejt të kryhet. **Nijazi Idrizi** apeloi te ministri për masa më efektive në këtë ministri, pikat grumbulluese të rriten, serrat të favorizohen, të aplikojnë fermerët në çdo kohë e jo vetëm në kohë të caktuar dhe fermerët të përfitojnë maksimalisht. **Ministri** bëri ca krahasime duke cekur se BE investon 42% në bujqësi, prej të cilave 31 subvencione, 11 grande. Përfaqësuesit ndërkombëtar në Kosovë kundërshtojnë subvencionet edhe pse ato i kanë në vendin e vet, çka do të thotë se ato çrregullojnë tregun, Evropa aplikon më tepër pagesa të drejtpërdrejta si ndihmë. Ministri theksoi se me rrjetin këshillues Kosova ka arritur të rritë prodhimin e qumshtit, ndërsa për serra nuk kishte përgjigje për shkak të mungesës së të dhënave si dhe për ujtitje gjithashtu. **Sevdije Lama** pyeti për realizimin e pagesave në mes AUV dhe Komunave si dhe për shifra statistikore në mes BE dhe Kosovës. Për të dy pyetjet Ministri nuk kishte përgjigje të sakt, ngase AUV nuk është në kuadër të MB por kjo është kërkuar gjithsesi të bëhet ngase dyjat janë një trup. Për pyetjen e dytë gjithashtu tha se gjithçka është e lidhur me regjistrimin në bujqësi, çka mungon. Ky projekt, vazhdoi, fillon në korrik të sivjetit dhe do të përfundoj më 2014. **Nait Hasani** vazhdoi me parashtrimin e pyetjes rreth mundësisë së uljes së kamatave për prodhues bujqësor për çka ministri njoftoi për aktivitetet në vazhdim rreth kredive në nivel të brendshëm komercial, ndaj mbetet kjo të rregullohet me rishikimin dhe mundësinë e startimit në vitin 2013. Ndërsa në pyetjen e kryetarit pse nuk vjen projektligji për pyje, ministri premtoi se kjo çështje

përfundon më 6 qershor në Qeveri, pasi që është dashur harmonizimi me dy ligjet për parqe nacionale. Rreth pyetjes së kryetarit për shkatërrimin e Tokës bujqësore në vazhdimësi dhe a ngriten procedurat ndëshkuese, ministri gjithashtu nuk kishte mundësi të jap përgjegje të sakt, ngase mungojnë njoftimet për vitin vijues, gjithashtu edhe për shkak se MB jap vetëm pëlqimin por jo edhe lejen, ai kërkoi të gjendet një zgjidhje e përbashkët. Mirëpo kryetari citoi nenin 15 ku thuhet se përjashtim bëjnë vetëm ndërtimet në interes publik, ndaj pse ndodhin shkatërrimet.

4. Organizimi i debatit në Pejë dhe të ndryshme

Kryetari Nait Hasani para se të hap debatin për takimin në Pejë, kërkoi rishqyrtimin e amendamenteve për Projektligjin e Ndërtimit, ngase nga grupet parlamentare është kërkuar të hiqen nenet 5,6,11,24,27 dhe 32. **Liburn Aliu** kundërshtoi këtë iniciativë ngase ky komision me marrëveshje ka përfunduar me 39 amendamente shqyrtimin e projektligjit në fjalë më 21 maj 2012, ndaj po të vendoset për heqjen e këtyre amendamenteve kjo do të thotë se votohet për heqjen e mbikëqyrjes së ligjit dhe është jo etike. Komisioni në vijim nxori :

P Ë R F U N D I M

- 1. Fshihet** Amendamenti 27 i Komisionit nga data 21.5.2012, ndërsa Amendamentet 5,6,11,24 dhe 32 do të përcjellën mbledhjes plenare për leximin e dytë në emrin e deputetit **Liburn Aliu**, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.
- 2. Miratohet** riformulimi i Komisionit për Legjislacion për nenin 9 duke shtuar në paragrafin 2 në fund : ” , **përveç nëse vendos ndryshe organi kompetent.**”

Në vazhdim **Sabiha Shala**, përfaqësuese e qendrës nacionale për analizë të Legjislacionit Evropian –NACEL- kërkoi konfirmimin e komisionit për marrëveshje të bashkëpunimit, dhe japi sqarime të duhura për Komisionin.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Miratohet kërkesa e qendrës nacionale për analizë të Legjislacionit Evropian –NACEL- për marrëveshje të bashkëpunimit, ndaj kërkohet nga Sekretari i Kuvendit protokollimi dhe nënshkrimi lidhur me këtë bashkëpunim me qendrën në fjalë.

Lidhur me debatin në Pejë për Projektligjin për Bjeshkët e Nemuna më 29 maj 2012, kryetari **Nait Hasani** ftoi pjesmarrësit në këtë debat, tre ekspertët prezent dhe përfaqësuesin e Bordit Mjedisor për të koordinuar veprimet e përbashkëta për një debat sa më të frytshëm me zyrtarët dhe fshatarë të interesuar të asaj ane. Pasi që u koordinuan punët, komisioni angazhoi stafin rreth realizimit të debatit në Pejë dhe në Rugovë më 30 maj me banorë të interesuar.

Mbledhja përfundoi në orën 14,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani